



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) stafi të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes TNE23-00059 - HEALTH-CONNECT Project që zhvillohet në
bashkëpunim nga
Universiteti Politeknik i Barit me Universitetin Politeknik të Tiranës**

Në kuadër të projektit TNE23-00059 - HEALTH-CONNECT që zhvillohet në bashkëpunim nga
Universiteti Politeknik i Barit me Universitetin Politeknik të Tiranës hapet thirrja për:

- **mobilitete stafi (TNE Faculty)**

Këto mobilitete fokusohen në tema të lidhura me arkitekturën, rigjenerimin urban dhe atë të peizazhit, planifikimin e qëndrueshëm dhe mjedise banimi me prioritet çështjet e shëndetit në përputhje me qasjen One Health.

Mobiliteti përfshin: Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie.

Numri total i stafit: 4

Mobiliteti i stafit: 5 ditë qëndrimi dhe 2 ditë udhëtimi dhe mobiliteti duhet të përfundojë deri në 20 Maj 2026.

Shpenzimet e ushqimit, akomodimit dhe udhëtimit të kryera gjatë periudhës së mobilitetit.

Çdo anëtar vizitues i stafit akademik dhe kërkimor do të pajiset me akomodim në hotel me gjysmë pensioni, pra mëngjes dhe darkë, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, përkatësisht bileta vajtje-ardhje me avion dhe transfertat aeroport–qytet, do të rimbursohen, me kusht që të dorëzohen dokumentet mbështetëse, deri në shumën 300 EUR.

Shpenzimet e udhëtimit do të rimbursohen mbi bazën e kostove të pranura, me kusht që të dorëzohen dokumentet mbështetëse dhe deri në shumën maksimale si më sipër. Çdo kosto që tejkalon këtë shumë do të mbulohet plotësisht nga anëtari i stafit.

Procedurat për raportim dhe pagesë, si dhe të gjitha kushtet e tjera të pjesëmarrjes, do të përcaktohen në Kontratën e Mobilitetit të nënshkruar ndërmjet anëtarit të stafit dhe Universitetit Politeknik të Barit – Itali në fillim të periudhës së mobilitetit.

Për të kërkuar rimbursimin e shpenzimeve të udhëtimit, stafi akademik dhe kërkimor i përzgjedhur duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm deri në fund të periudhës së mobilitetit në:

tne-arcod@poliba.it

- kopje të biletës së avionit të blerë
- kopje të të gjitha shpenzimeve të pranueshme, p.sh. taksi

Çdo kosto që tejkalon shumën maksimale të përcaktuar do të mbetet plotësisht në ngarkim të anëtarit të stafit.

Çdo anëtar i përzgjedhur i stafit akademik dhe kërkimor që merr pjesë në programin e mobilitetit do të jetë gjithashtu plotësisht përgjegjës për mbulimin e kostove të mëposhtme:

- sigurimi i udhëtimit dhe shëndetit, i vlefshëm për të gjithë periudhën e mobilitetit
- çdo kosto shtesë, përfshirë tarifën për aktivitete sportive ose shërbime të tjera opsionale



Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër Motivimi
- Certifikatë në nivelin B2 të gjuhës angleze dhe/ose italiane.
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Training)**.
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me aktivitetet gjatë mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës* ;



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

*Plani i mobilitetit, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikani bën pjesë.

** Mobility Agreement for Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Afati për aplikim: Deri më 17 Prill, 2026, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT. Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në e-mail: rkodra@upt.al, abeqo@upt.al

Përzgjedhja përfundimtare do të bëhet nga Univeristeti Politeknik i Barit. Per me teper informacion, konsultohuni me dokumentet pdf bashkelidhur thirrjes.